

LIGJ
Nr. 15/2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 97/2013, “PËR MEDIAT AUDIOVIZIVE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 shtohen përkufizimet, si më poshtë:

“54. “Regjistri i pronësisë së OSHMA-ve” është bazë të dhënash elektronike e administruar dhe e publikuar nga AMA, në të cilin regjistrohen të dhënat për strukturën pronësore dhe pronarin përfitues sipas legjislacionit në fuqi për mediat audiovizive dhe për regjistrin e pronarëve përfitues, me qëllim garantimin e transparencës së pronësisë të shoqërive mediatike.

55. “Pronar përfitues”, “pronësi direkte” dhe “pronësi indirekte” kanë kuptimin e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për regjistrin e pronarëve përfitues, të zbatueshme dhe të interpretuara në funksion të garantimit të transparencës së pronësisë së subjekteve OSHMA.”.

Neni 2

Pas nenit 33 shtohet neni 33/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 33/1

Transparenca pronësore mediatike

1. AMA siguron që çdo ofrues i shërbimit mediatik që është nën juridiksionin e saj të bëjë lehtësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të aksesueshëm në mënyrë të përhershme për marrësit e një shërbimi të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin;
- b) adresën gjeografike në të cilën ndodhet;
- c) të dhënat, duke përfshirë adresën e *email*-it ose faqen e internetit, të cilat mundësojnë që ai të kontaktohet menjëherë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe efektive;
- ç) autoritetet ose organet rregullatore kompetente ose organet mbikëqyrëse që shikuesit mund t’u referohen.

2. Ofruesit e shërbimeve mediatike bëjnë lehtësisht të aksesueshëm për marrësit e shërbimeve të tyre informacionin e përditësuar për strukturën pronësore dhe në veçanti për:

- a) emrin ose emrat e pronarëve të tyre të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që kanë aksione dhe u mundësojnë atyre të ushtrojnë ndikim në funksionimin dhe vendimmarrjen strategjike, duke përfshirë pronësinë direkte ose indirekte nga një shtet ose nga një autoritet ose subjekt publik;
- b) emrin ose emrat e pronarëve të tyre përfitues;

¹ Ky ligj përafron Rregulloren (BE) 2024/1083 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 11 prillit 2024, që krijon një kuadër të përbashkët për shërbimet mediatike në tregun e brendshëm dhe ndryshon direktivën 2010/13/BE (Akti Evropian për Lirinë e Medias), numri CELEX: 22024R1083, Fletore Zyrtare e BE-së, seria L, datë 17.4.2024.

c) shumën totale vjetore të fondeve publike për reklamat shtetërore që u ndahen atyre dhe shumën totale vjetore të të ardhurave nga reklamat e marra nga autoritetet ose subjektet publike të vendeve të treta.

Me qëllim verifikimin e të dhënave të marra dhe sigurimin e informacionit të përfitësuar dhe të kryqëzuar, AMA bashkëpunon me Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), e cila ofron informacionin e kërkuar në kohë dhe në përputhje me dispozitat e ligjit.

3. Këto masa duhet të respektojnë të drejtat themelore, si jeta private dhe familjare e pronarëve përfitues në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto masa duhet të jenë të nevojshme dhe proporcionale dhe të synojnë arritjen e një qëllimi me interes të përgjithshëm.

4. AMA mban databazën kombëtare të pronësisë mediatike, që përmban informacionin e përcaktuar në pikat e mësipërme.”.

Neni 3

Në nenin 133 pas pikës 8 shtohet pika 8/1 me këtë përmbajtje:

“8/1. Me gjobë nga 50 000 deri në 500 000 lekë për shkelje të detyrimeve të parashikuara nga pika 2 e nenit 33/1 të këtij ligji.”.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 28.1.2026.

Shpallur me dekretin nr. 49, datë 5.2.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.